



VENDIM
Nr.92 Datë 08.12.2009

PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “EGL ALBANIA” SH.A NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pika 1, gërma “d”, dhe nenit 8, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 4, gërma “g”; 5; 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës .12.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “EGL Albania” sh.a për liçensim në aktivitetin e Tregëtimit të Energjise Elektrike,

dhe Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “EGL Albania” sh.a plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- o Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërma “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërma “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërma “a”, “b” dhe “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,



Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë “EGL Albania” sh.a në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN
Nr.92 Datë 08.12.2009

PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “EGL ALBANIA” SH.A NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____

